



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

Në bazë të Nenit 3 pika 7 dhe të Nenit 11 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës (LSHCRK), përkatësisht të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, Institucioni i Avokatit të Popullit shpall:

K O N K U R S

I. Titulli i vendit të punës: Udhëheqës i Departamentit të Prokurimit

Referenca: IAPK – 1/2014

Koeficienti: 10

Mbikqyrësi: Drejtori Ekzekutiv

Kohëzgjatja e emërimit: me afat të pacaktuar, peruudha provuese 12 muaj.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Drejton, menaxhon dhe planifikon aktivitetet e prokurimit në pajtim me Ligjin e Prokurim Publik në Republikën e Kosovës,
- Zhvillimin, rishikimin dhe aprovimin e procedurave të reja apo të përmirësuara administrative për furnizimet, shërbimet dhe punët e ndryshme, në mënyrë që furnizimet, shërbimet dhe punët të jenë konformë kërkesës dhe me operator ekonomik dhe efikas,
- Përgatitë dhe mirëmban dosjet e tenderëve/prokurimeve të cilat përmbajnë lëndën e kontratës, afatet kohore për pranimin e tenderëve, kriteret e përzgjedhjes, kriteret për dhënien e kontratës, sigurinë e tenderit, të ekzekutimit, kriterëve dhe kushteve tjera që kërkohen sipas rregullave të prokurimit publik në Kosovë,
- Përgatitë publikime për prokurimet, organizon dhe siguron mbarëvajtjen e procedurave të parapara për hapjen, ekzaminimin, krahasimin dhe vlerësimin e tenderit,
- Siguron procedurën dhe lidhjen e kontratave në bazë të kriterëve të caktuara në dosjen e tenderit dhe sipas vlerës së shërbimit, furnizimit dhe punëve që ofrohen, me qëllim që mjetet publike të shfrytëzohen në mënyrë të drejtë dhe efikase,
- Interpretimin e dispozitave të kontratës dhe rishikimin e kontratave për saktësi dhe ndryshime para ofertimit dhe ripërtëritjes së tyre;
- Përcjell, zhvillon, avanco procedurat dhe ndërmerr iniciativa për forcimin e procedurave të prokurimit, në aspektin sa më ekonomik dhe efektiv,
- Siguron transparencë dhe ndërmerr të gjitha masat e domosdoshme, të parapara me legjislacionin për prokurimin publik në Republikën e Kosovës, për shmangien e “konfliktit të interesit”
- Siguron mbarëvajtjen e procedurave të parapara për ankesat lidhur me tenderin,
- Kryen detyra të tjera që kërkohen dhe mund t’i caktohen nga mbikëqyrësi i tij.

Përgaditja profesionale, kualifikimi, aftësitë dhe karakteristikat tjera:

- Diplomë universitare të fakultetit ekonomik, juridik, administratës publike apo drejtimit tjera universitare – e obligueshme, kurse studimet Master ose kualifikimet më të avancuara-të dëshirueshme,
- Së paku 2 (dy) vjet përvojë pune në sektorin e prokurimit – e obligueshme;
- Çertifikatë profesionale për prokurim, të lëshuar nga IKAP - e obligueshme ;
- Njohuri të avancuara për aplikacionet e pakos Microsoft Office (MS Word, Excel, Power Point, Internet Explorer dhe grafika të tjera për prezantime softwerike).
- Njohja e gjuhës shqipe dhe/ose serbe, e obligueshme, kurse njohja e gjuhës angleze – e dëshirueshme,
- Të punojë i pavarur, nën presion, i motivuar për punë ekipore dhe me njerëz të përkatësive të ndryshme,
- Vërtetimin nga gjykata se nuk është nën hetime apo i dënuar për vepër penale (jo më i vjetër se 6 muaj) – i obligueshëm.

Procedura e konkurimit

Procedura e konkurimit është e hapur për të gjithë kandidatët të cilët i përmbushin kriteret e konkursit.

[Formularët për punësim](#) mund të merren në zyrën e IAP, apo në ueb faqen e internetit: www.ombudspersonkosovo.org.

Formularët për punësim mund të dorëzohen personalisht në zyrën qendrore të Institucionit të Avokatit të Popullit në Prishtinë, Rr. „Enver Maloku“, nr. 28, Bregu i diellit, 10 000 Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 08:00 – 16:00 deri në afatin e fundit për konkurrim.

Formularit për punësim i bashkëngjiten kopjet e dokumenteve të nevojshme personale dhe dëshmitë për kualifikim, përvojë të punës, trajnimet e ndjekura si dhe vërtetimin se nuk është nën hetime apo i dënuar për veprë penale.

Informatë e përgjithshme për të gjithë kandidatët

Institucioni i Avokatit të Popullit ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës pa asnjë dallim.

Komunitetet jo shumicë kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil siç specifikohet në nenin 11, paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Në rast të numrit të madh të aplikacioneve, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Konkursi mbetet i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e publikimit në shtypin ditor. Data e fundit për aplikim është 14 mars 2014.

Kërkesat e dërguara pas kalimit të afatit për aplikim, dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen.

Për informata shtesë, ju lutem kontaktoni në numrin e telefonit 038 223 782

Vërejtje: Kandidatët që kanë aplikuar por, nuk janë zgjedhur, mund t'i tërheqin dokumentet e tyre pas përfundimit të procedurës së rekrutimit dhe të ankimimit, gjegjësisht 90 ditë nga momemnti i skadimit të afatit të aplikimit. Dokumentet që nuk tërhiqen asgjësohen.